

# INFORMACIONE



## KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

### PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUAJIT TETOR

4-9 Tetor	KOKSH – ICMG – AEFS Seminar Formues për Trainerë “Metodologjia e Stërvitjes Sportive”
4 Tetor	Delegacioni i “Scuola dello Sport”– Takim në KOKSH
4-9 Tetor	KOKSH - CIO
5 Tetor	Përfundon me Sukses KOMPAS II
9-16 Tetor	KOKSH – KOE - FITA Seminar Trainues « Zhvillimi dhe përhapja e Sportit të Harkut në Shqipëri »
13 Tetor	Mbledhje e KAS
15 Tetor	Takim me AMC
18 Tetor	KOKSH & UNDP & Bashkia Durrës
22 Tetor	Aktivitetet e “UN Week”
23 Tetor	Asamblea e 10-të Zgjedhore e KOKSH, Korçë.
25 Tetor	KOKSH & Ambasada Franceze
26 Tetor	Stafi i KOKSH vizitë pune në K.O.Maqedonas
28 Tetor	Delegacion i COE në Tiranë
29 Tetor	KOKSH – Konferencë Shtypi
29 Tetor	Presidenti i Federatës Botërore të Gjymnastikës takim pune në KOKSH

# TETOR 2004

## 4-9 Tetor

### KOKSH – ICMG – AEFS

#### Seminar Formues për Trainerë

KOKSH, në bashkëpunim me AEFS «Vojo Kushi» dhe nën kujdesin e programit ICMG të Lojrave Mesdhetare, ka organizuar për një javë rresht në ambjentet e AEFSs seminarin formues me tematikë :

#### « Metodologjia e Stërvitjes Sportive »

“Scuola dello Sport” e Sicilisë dërgoi në Tiranë tre Lektorë të cilët trajtuan tema që kishin të bënin me :

- *Metodologjia e Stërvitjes Sportive*
- *Psikologjia Sportive e Zbatuar dhe*
- *Mësimdhënia në Edukimin Fizik dhe Sport*

Pjesmarrës në seminar ishin pedagogë të AEFS, trainerë profesionistë dhe mësues të edukimit fizik. Seminari ishte i ndarë në sesione leksionesh, diskutimesh dhe punë në grup të pjesmarrësve. Në fund 30 pjesmarrësit të cilët përfituan nga ky seminar u pajisën me nga një libër të përgatitur nga Scuola dello Sport, materiale të ndryshme në CD dhe certifikatë të pjesmarrjes.

## 4 Tetor

### Delegacioni i “Scuola dello Sport”– Takim në KOKSH

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello priti në ambjentet e KOKSH delegacionin e Scuola dello Sport e Sicilisë të CONI-it. Delegacioni i përbërë nga Presidenti z. Rosario Cintolo dhe Drejtori i Scuola dello Sport z. Salvatore Ottaviano, erdhën në Tiranë për të zhvilluar takime në KOKSH dhe AEFS në mënyrë që të vendosen ura bashkëpunimi për shkëmbim eksperiencash dhe kualifikim trainerësh. Gjithashtu pjesë e delegacionit ishin edhe lektorët e Universitetit të Kataniës dhe Messinës të cilët kishin ardhur për të zhvilluar Seminarin Formues mbi Metodologjinë e Stërvitjes Sportive.

## 4-9 Tetor KOKSH - CIO

Pas përfundimit më sukses nga Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH i (MEMOS) Masterit mbi Administrimin e Organizatave Sportive, Përgjegjësjë e Mardhënieve me Median dhe

Publikun e KOKSH, znj. Elda Gjoka, ka fituar të drejtën për të ndjekur Masterin 1 vjeçar më prestigjioz në administrimin e organizatave sportive që organizon Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (CIO) në Lozanë të Zvicrës – *Master Ekzekutiv në Administrimin e Organizatave Sportive* (MEMOS) - Edicioni VIII. Në datat 4-9 Tetor është zhvilluar moduli i parë i Masterit 1 –vjeçar.

## 5 Tetor - Përfundon me Sukses KOMPAS II

Është mbyllur me sukses edicioni i dytë i Kursit Olimpik të Administratorëve Sportivë (KOMPAS II). Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar në bashkëpunim me AEFS «Vojo Kushi» dhe financuar nga MKRS në periudhën Shtator 2003 -Tetor 2004 ka organizuar të Shtunën e fundit të çdo muaji Kursin Olimpik të Administratorëve Sportivë, ku përveç lektorëve shqipëtarë nuk kanë munguar edhe lektorët e huaj dhe mjaft të njohur në Europë në fushën e menaxhimit dhe marketingut sportiv për të dhënë eksperiencën, konceptet bazë dhe idetë më të fundit në këtë fushë.

Në datën 5 Tetor në ambjentet e AEFS «Vojo Kushi» u zhvillua seminari i fundit i kursit i cili përkonte me mbrojtjen e temave të përgatitura nga studentët, ku të 19 studentët në praninë e tutorëve dhe para një komisioni të zgjedhur, prezantuan temat e tyre. Në Ceremoninë e dhënies së Diplomave e cila u organizua në Hotel Diplomat , z. Stavri Bello Sekretar i Përgjithshëm i KOKSH, z. Korab Llazani (MKRS) dhe z. Sejfulla Shtëpani (Rektor i AEFS «Vojo Kushi»), përshëndetën kursantët e sapodiplomuar dhe i'u uruan që ky kurs formues të kontribuoj në zbatimin e këtyre koncepteve të menaxhimit dhe marketingut. Ceremoninë e përshëndeti edhe Presidenti i Scuola dello Sport e Sicilisë z. Rosario Cintolo i cili e vlerësoi këtë kurs për vetë specifikën e tij. Në Ceremoninë e dhënies së diplomave kishte të ftuar nga MKRS, Federatat sportive, AEFS, media dhe mjaft institucione të tjera sportive.

### 9-16 Tetor KOKSH – KOE - FITA Seminar Trainues « Zhvillimi dhe përhapja e Sportit të Harkut në Shqipëri »

KOKSH në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Harkut, financuar nga Komiteti Olimpik European (KOE) dhe Federata Ndërkombëtare të Harkut (FITA) zhvilluan për herë të parë në Shqipëri në qytetin e Durrsit (Golem) seminarin « *Zhvillimi dhe përhapja e sportit të harkut në Shqipëri* ». Për 6 ditë me rradhë i ngarkuari i FITAs nga Spanja, treneri dhe Kampioni Olimpik z. Juan Carlos Holgado dhe instruktori i Harkut z. Claudio Foiera nga Italia, drejtuan këtë seminar ku morën pjesë 18 persona nga të cilët 4 ishin femra. Pjesëmarrësit ishin nga Shoqata e Harkut, mësues të edukimit fizik dhe amatorë. Seminari u nda në dy sesione në atë teorik dhe praktik dhe qëllimi kryesor i sesioneve konsistonte në krijimin e bazave themelore për zhvillimin e Harkut në Shqipëri i cili do të pasohet me seminare të tjerë të nivelit të dytë dhe të tretë. Ekspertët gjithashtu u pritën në ambjentet e KOKSH nga Sekretari i përgjithshëm z. Bello i cili theksoi se KOKSH do ta mbështesë këtë iniciativë për të zhvilluar më tej sportin e Harkut në Shqipëri duke përdorur të gjitha kapacitetet e mundshme që disponojmë.

### 13 Tetor Mbledhje e KAS

Në ambjentet e KOKSH është zhvilluar mbledhja e KAS për të marrë në shqyrtim dy ankesa të drejtuara në KAS. Këshilli i kryesuar nga kryetari z. Begeja, si rend të ditës kishte :

- Shqyrtimin e ankesës së Klubit Sportiv Studenti (Basketboll) që përkonte me anulimin e vendimit nr. 120 të datës 27.09.2004 të Komisionit të Disiplinës së F.SH.B-së.
- Shqyrtimin e ankesës së Klubit Sportiv shumë-sportësh Flamurtari i cili kërkonte anulimin e vendimit nr. 171 të datës 19.09.2004 të Komisionit të Disiplinës të F.SH.Boksit.

### 15 Tetor Takim me AMC

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH Stavri Bello, në kuadër të partneritetit të vazhdueshëm me AMC-Sponsor Zyrtar i KOKSH, organizoi një takim dypalësh ku u konfirmuar përfshirja

e AMC si partner ekskluziv i Projektit të KOKSH – UNDP dhe Agjensive të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, në kuadër të “UN Week” – Javës së Kombeve të Bashkuara 17-24 Tetor.

### 18 Tetor KOKSH & UNDP & Bashkia Durrës

Kanë zhvilluar një takim të përbashkët, në zyrën e Kryetarit të Bashkisë së Durrësit Z. Lefter Koka për të koordinuar për organizimin sa më optimal të projektit në qytetin e Durrësit në datën 22 Tetor në Kuadër të “UN Week”. Nga ana e tij, kreu i Bashkisë Durrës, garantoi angazhimin e institucionit të tij për realizimin e suksesshëm të nismës.

### 22 Tetor Aktivitetet e “UN Week”

Në kuadër të UN week (Java e Kombeve të Bashkuara) u organizua aktiviteti « *Rinia – një zë i ri dhe i fuqishëm për të arritur qëllimet e Mileniumit për zhvillim* ». Aktiviteti u bë i mundur nga bashkëpunimi i KOKSH me Bashkinë Durrës, Agjensitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe Kompania e telefonisë celulare AMC. Fokusi dhe qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti ishte të promovojë zhvillimin e të rinjve dhe një jete të kënaqëshme nëpërmjet sportit.

### 23 Tetor

#### Asambleja e 10-të Zgjedhore e KOKSH, Korçë.

Në qytetin e Korçës në Hotel « Kristal », u zhvillua Asambleja e 10-të dhe njëkohësisht zgjedhore e KOKSH.

Z. Hysen Domi President i KOKSH gjatë periudhës 2000 – 2004 u rimandatua President i KOKSH edhe për 2004-2008. Gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm, Stavri Bello.

Anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të KOKSH u zgjodhën:

Ela Tase  
Genc Ruli  
Viron Bezhani  
Fidel Ylli  
Koço Mikerezi  
Vladimir Gjoni  
Genc Boga  
Klodiana Shala  
Hyrmete Gjeta

## 25 Tetor KOKSH & Ambasada Franceze

Në ambjentet e KOKSH Sekretari i Përgjithshëm z. Bello zhvilloi një takim pune me përfaqësuesen e ambasadës Franceze në Tiranë znj. Catherine Choussianov, përgjegjëse për kulturën dhe sportin. Qëllimi i këtij takimi ishte në fokusin e bashkëpunimit dhe mbështetjes së projekteve të ndryshme në kuadër të zhvillimit dhe edukimit nëpërmjet sportit.

## 26 Tetor

### Stafi i KOKSH vizitë pune në K.O.Maqedonas

Në kuadër të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave midis Komiteteve Olimpikë Kombëtare, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH bashkë me stafin e tij, me një ftesë të bërë nga K.O.Maqedonas kanë bërë takime me Presidentin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorin e Sporteve të KOM. Gjithashtu stafi i KOKSH ka vizituar ambjentet e KOM dhe është njohur në përgjithësi me projektet të cilët ata organizojnë. Sipas profilit të punëve, secili nga anëtarët e stafit të KOKSH ka kontaktuar me kolegët e tyre të KOM për të njohur mënyrën e organizimit të punës së tyre. Pritja ishte shumë e ngrohtë dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello i shprehu homologut të tij se KOKSH së shpejti do të dërgojë ftesën zyrtare që stafi i KOM të vijë në Shqipëri.

## 28 Tetor Delegacion i COE në Tiranë

Një delegacion ekspertësh i përberë prej tre vetësh i Komitetit Olimpik Europian znj. Sabrina Rettondini, z. Federico Pizzardi dhe z. Giovanni De Angelis zhvilluan një vizitë pune në Tiranë. Delegacioni u prit nga Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH në ambjentet e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Qëllimi i vizitës së tyre ishte inspektimi i kushteve në kuadër të organizimit të Seminarit të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të COE ku siç dihet Shqipëria ka fituar të drejtën e organizimit të këtij evenimenti i cili do të organizohet në Maj të vitit 2005.

## 29 Tetor KOKSH – Konferencë Shtypi

Ditën e Premte më dt. 29 Tetor 2004 në ambjentet e Hotel Tirana International, KOKSH dha një Konferencë Shtypi për të informuar Publikun dhe Median, mbi ecurinë normale të procesit zgjedhor të Asamblesë së 10-të Zgjedhore e cila u zhvillua në qytetin e Korçës në datë 23 Tetor 2004.

## 29 Tetor

### Presidenti i Federatës Botërore të Gjimnastikës takim pune në KOKSH

Presidenti i Federatës Botërore të Gjimnastikës z. Bruno Grandi dhe Sekretari i Përgjithshëm i saj z. Andre Gueisbuhler të shoqëruar nga Presidenti i Federatës Shqiptare të Gjimnastikës janë pritur nga Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello. Qëllimi i takimit ishte krijimi i urave të bashkëpunimit midis FIG, KOKSH dhe FSHGJs në përmirësimin e infrastrukturës së sportit të gjimnastikës dhe në mënyrë të veçantë krijimin e mundësive për kualifikimin e vazhdueshëm të trenerëve të këtij sporti. Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello i falenderoi për vizitën dhe theksoi se me anë të këtij interesimi nga FIG ky është një aspekt shumë i rëndësishëm edhe për KOKSH që të ketë një nxitje më të madhe në ecurinë dhe përmirësimin sportit të gjimnastikës në Shqipëri.